

V E N D I M
Nr. 419, datë 4.8.2000

PËR OBJEKTET E RREZIKSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, te pika 16, të ligjit nr. 7986, datë 13.9.1995, "Për Inspektoriatin Shtetëror të Punës", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e objekteve të rrezikshme, për parandalimin e rrezikut në punë, për mbrojtjen e shëndetit dhe për sigurimin në punë.

2. Në kuptimin e këtij vendimi objekte të rrezikshme janë:

a) Lokalet (repartet) e punës, rrugët e qarkullimit dhe daljet në rastet emergjente që janë në funksion të sigurimit në punë të punonjësve.

b) Pajisjet e ndryshme, veglat e punës dhe makineritë, me të cilat punojnë punëmarrësit.

c) Makinat, ngritëse e transportuese (aksesorët, vinçat e të gjitha tipave, talet, monorelsat, elektro-tale, parafangot, etj).

ç) Makineritë metalprerëse.

d) Makineritë rrotulluese (torno, freza, trapan, retifika etj).

dh) Betonierat.

e) Makineritë e përpunimit të drurit.

ë) Kaldajat e avullit të ujit të mbinxehur dhe enët nën presion.

f) Transportierët, elevatorët.

g) Mjetet e transportit tokësor, detar dhe ajror.

gj) Pajisjet dhe instalimet elektrike, me të cilat operohet në një ndërmarrje.

h) Pajisjet dhe mjetet e mbrojtjes kundër zjarrit.

i) Pajisjet dhe mjetet për mbrojtjen nga shkarkesat elektrike.

j) Pajisjet që mbartin mallra të rrezikshme si cisternat, rezervuarët, bombolat etj.

3. Personat, juridikë dhe fizikë, prodhues dhe përdorues, janë të detyruar të njohin, të respektojnë dhe të pajisin me rregulloren e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes nga zjarri, për çdo objekt që vlerësohet i rrezikshëm për punëmarrësit.

4. Punëdhënësit, drejtuesit dhe përgjegjësit, që veprojnë, drejtojnë apo mbikqyrin veprimtaritë (punët) e treguara në pikën 2 të këtij vendimi, janë të detyruar që çdo punëmarrësi, që fillon punën në subjektin e tij, t'i japin informacionin e duhur për njohjen me rregullat e sigurimit teknik për vendin e punës ku do të punojë. Kjo bëhet në mënyrë periodike dhe jo më pak se një herë në muaj e sa herë që ndryshon procesi i punës.

5. Për të gjitha makineritë dhe vendet e reja të punës, para vënies së tyre në shfrytëzim, duhet të hartohen dhe të vendosen rregullat e sigurimit dhe ato të shfrytëzimit, për të cilat punëmarrësit duhet të kenë udhëzim të plotë.

6. Punëdhënësi mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mosnjohjen e rregullave të sigurimit teknik nga punëmarrësit.

7. Punëdhënësi mban një regjistër për instruktimin e teknikës së sigurimit. Ky regjistër përmban procesverbalet për temat e zhvilluara dhe firmoset nga instruktori dhe punëmarrësit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta